



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 14 Maj 2021

Nr. 357

VENDIM

Objekt: Për shqyrtimin administrativ të denoncimit, të qytetarit z. Murat Shallari për shkelje të parashikuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ndaj Postës Shqiptare, dega Skrapar

Kërkues: Murat Shallari

Ndaj: Postës Shqiptare, dega Skrapar

Baza Ligjore: Nenet 19, paragrafi 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, paragrafi 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 23 dhe 24 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e administratës së KQZ-së paraqitur gjatë shqyrtimit administrativ,

VËREN:

I.Vlerësimi Paraprak

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1324 prot., datë 13.04.2021, administruar nga KQZ me nr. 3702 prot., datë 13.04.2021, është raportuar nga Institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë, denoncimi i qytetarit, z. Murat Shallari ndaj Postës Shqiptare, dega Skrapar me pretendimin se, kjo e fundit kërkon numrat e kartave të identitetit të pensionistëve, duke i kërcënuar se do u pritet pensioni në rast se nuk paraqesin numrat e kartavetë identitetit. Përveç



Data: 14 Maj 2021
Nr. 357

Për shqyrtimin administrativ të denoncimit, të qytetarit z. Murat Shallari për shkelje të parashikuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ndaj Postës Shqiptare, dega Skrapar

denoncimit, z. Shallari nuk ka paraqitur asnjë dokument apo material shtesë provues lidhur me këtë denoncim.

Referuar nenit 23 të ligjit nr. 44/20151 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, “*Me fillimin e procedurës administrative, organi publik verifikon nëse ka apo jo kompetencë lëndore dhe tokësore për të vendosur për çështjen objekt shqyrtimi.*”

Sipas përcaktimeve të neneve 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e paragrafi 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se të dhënat e paraqitura nga denoncuesi z. Murat Shallari, përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

II. Rrethanat e faktit

Referuar denoncimit të mësipërm, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 4184 prot., datë 21.04.2021, i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Postës Shqiptare, informacion sqarues në lidhje me këtë veprimtari të Postës Shqiptare ndaj qytetarëve të Skraparit.

Me shkresën nr. 882/1 prot., datë 29.04.2021, administruar me tonën me nr. 4184 prot., datë 30.04.2021, administratori i Postës Shqiptare sh.a, z. Hipokrat Biba, ka kthyer përgjigje nëpërmjet së cilës na informon se:

Pas komunikimit me Filialin e Postës Berat dhe me Degën e Postës Skrapar, në Filialin e Postës Berat, me futjen e të gjitha shërbimeve në Eternën Financiare dhe shërbimi i Ndihmës Ekonomike dhe Paafëtisë ka kaluar në këtë sistem. Çdo personi që paraqitet për të përfituar nga ky shërbim, i kërkohet dokumenti i identifikimit, pasi sistemi nuk gjeneron të dhënat për asnjë person. Lidhur me ankesën e z. Murat Shallari,



sipas z. Biba, kjo ankesë është e pabazuar pasi i ati i tij, z. Hajri Shallari, përfiton pagesën e paaftësisë, si i verbër dhe numri i kartës së identitetit në sportelin e Postës Skrapar, i është kërkuar pikërisht për të gjeneruar të dhënat e tij në këtë sistem.

III. Analiza ligjore

Referuar pretendimit të denoncuesit për sjelljen jo të ligjshme sipas tij të institucionit të Postës Shqiptare, dega Skrapar, duke aluduar se kërkesa e kartës së identitetit, për marrjen e pensionit të të atit të denoncuesit, z. Shallari, mund të jetë për qëllime zgjedhore, neni 92 i ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon:

“1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.

2. Në kuptim të këtij neni, “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim.”

Referuar përgjigjes së dhënë nga administratori i Postës Shqiptare, z. Biba, lidhur me veprimtarinë e kërkimit të kartave të identitetit qytetarëve të Skraparit, ndryshe nga ç’pretendohet nga denoncuesi z. Shallari, vlerësoj se ky veprim i kryer prej tyre është i ligjshëm dhe i nevojshëm për identifikimin dhe gjenerimin e të dhënave të personit që përfiton pension, nga sistemi.

Nuk rezultoi e provuar se, ky veprim i Postës Shqiptare ndaj qytetarëve të Skraparit përbën përdorim të “burimeve njerëzore” ku kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, sipas përcaktimeve të nenit 92 të Kodit Zgjedhor.

Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të vazhdojë shqyrtimin administrativ për denoncimin e kryer nga z. Murat Shallari pasi në përfundim të hetimit administrativ rezulton se,



veprimtaria e Postës Shqiptare, dega Skrapar nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenin 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, paragrafi 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 23 dhe 24 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”:

V E N D O S:

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit ndaj Postës Shqiptare, dega Skrapar pasi nuk konstatohen shkelje të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI

